

Ekskluzive

# Ekskluzive | Bastisje në Zubin Potok – Policia sekuestron armë, municion dhe pajisje ushtarake, 62-vjeçari përfundon në ndalim



Sinjali.com

07 Gusht 2026 09:57



**Një aksion i Policisë së Kosovës në fshatin Dren të Zubin Potokut ka rezultuar me sekuestrimin e një sasie armësh, municioni dhe pajisjesh ushtarake, ndërsa një 62-vjeçar është ndaluar për 48 orë.**

Sinjali mëson se i dyshuari është Radisa Kostovic rreth 62 vjeçar.

Sipas burimeve, hetimet kishin nisur pas informacioneve operative se i dyshuari mbante të fshehur armë dhe municion pa autorizim në pronën e tij.

Mbi bazën e këtyre informacioneve, Sektori Rajonal i Hetimeve në Mitrovicën e Veriut, me asistimin e njërive të tjera policore, ka realizuar bastisjen e shtëpisë dhe objekteve përcjellëse të të dyshuarit.

Gjatë kontrollit janë sekuestruar: një armë e gjatë gjuetie, një leje e armës, me afat të skaduar që nga 2 tetori 2005, një busull (kompas) ushtarak, një thikë ushtarake, një rrip me tetë fishekë, një librezë e Ushtrisë së Serbisë, tetë karikatorë me gjithsej 76 fishekë të armës automatike, si dhe shtatë fishekë për armë gjysmëautomatike.

Pas intervistimit, me urdhër të Prokurorit të Shtetit, ndaj Radisa Kostovicit është iniciuar procedurë për veprën penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, ndërsa ai është ndaluar për 48 orë.

Hetimet lidhur me rastin janë në vazhdim.

**Shënim: Personat e apostrofuar në këtë artikull prezumohen të pafajshëm derisa fajësia e tyre të mos provohet me vendim të formës së prerë nga gjykata.**

***Sinjali – aty ku e vërteta flet para lajmit!***

**/GazetaSinjali/**

bastisje

arme

## Të tjera:



**Bastisje në Ferizaj: Policia gjen kallashnikov e pistoletë në bagazhin e BMW-së – sekuestroh...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Bastisja për të shtënat me armë eskalon në Hajvali – dy persona sulmojnë...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Sulmi me granatë në Podujevë, bastisen shtëpitë e të dyshuarve – gjenden...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Sherri mes vëllezërve për biznesin në Prizren përfundon me bastisje në Ferizaj– një...**

**Sinjalizime**



**Ekskluzive | Bastisje për armë në Gjilan, Policia gjen pushkë gjuetie dhe municion në shtëpinë ...**

**Sinjalizime**



**Të shtëna me armë pas një konflikti në Prishtinë, Policia bastis shtëpinë e 25-vjeçarit**

**Sinjalizime**



**Mega-aksion i DKKO-së dhe Krimeve të Rënda në Kosovë, bastisen mbi 20 lokacione – priten...**

**Sinjalizime**



**Aksion i madh në Prishtinë për shpëlarje parash, bastisen disa lokacione dhe...**

**Ekskluzive**

## Sinjali

Gazeta Sinjali mirëmbahet nga kompania "Sinjali" sh.p.k. Materialet dhe informacionet e Gazetës Sinjali nuk mund të kopjohen, të shtypen, ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër, pa leje nga redaksia.



### Lajme

Zgjedhjet 2026  
Kosovë  
Shqipëri  
Rajon  
Diasporë  
Evropë  
Botë

### Aktualitet

Politikë  
Drejtimi  
Siguri  
Shëndetësi  
Arsim  
Sociale

### Hulumtime

Ekskluzive  
Profile  
Skandaloze

### Ekonomi

Prodhome Vendore  
Financa  
Biznes

### Sport

Botërori 2026  
Futboll  
Basketboll  
Sporte Luftarake  
Sporte të tjera

### Showbiz

Bota e Yjeve  
Modë & Stil  
Bukuri dhe kujdes  
Të tjera

### OP-ED

Analizë  
Kolumne  
Intervistë

### Jetë

Fitness  
Ushqime  
Travel  
Këshilla  
Receta  
Dieta  
Shëndeti

### Kulturë

Film  
Muzikë  
TV & Radio  
Libra  
Art & Dizajn  
Fotografi  
Histori

### Tech & Auto

Teknologji  
Automjete  
Telefona  
Internet  
Lojëra  
Aplikacione

### Fun

Qesharake  
Kuriozitete  
Kuize  
Fakte  
Të tjera